



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi në tërësi i projektligjit “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””

2. Miratimi nen për nen i projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Ervin Salianji , Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj, Myslym Murrizi, Sadi Vorpsi dhe Vullnet Sinaj,

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Flamur Noka dhe Endrit Brahimllari

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Alba Thoma - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes

Gentiana Milkani - Drejtore e Inspektimit në AKSHE

Eriola Karagjosi - Përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Legjislacionit në AKSHE.

Genti Cani – Drejtor i Analizës së Riskut dhe Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj - Kourumi për çeljen e mbledhjes së Komisionit të Sigurisë Kombëtare është konform Rregullores.

Mbledhjen e deklaroj të hapur.

Sot në rendin e ditës së komisionit kemi parashikuar miratimin në tërësi të projektligjit “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr.8378, datë 27.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”.

Është një nismë e kolegut Pjerin Ndreu dhe bëhet fjalë për një amendim në Kodin Rrugor, lidhur me procedurën e pezullimit të lejdrejtimit të shtetasve, që kanë leje drejtimi të lëshuar nga autoritet e huaja.

Së dyti, në rend të ditës kemi miratimin nen për nen të projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”. Është prezantuar projekti në parim në komisionin tonë. Ndërkohë është votuar pro në parim. Ne jemi komision përgjegjës për këtë projektligj, natyrisht që përfundimi i këtij projekti varet nga raporti që do të na vijë nga Komisioni i Integritimit.

Do të shqyrtojmë në fillim pikën e dytë të rendit të ditës, miratimin nen për nen të projektligjit “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve me teknologji dhe përdorim të dyfishtë”.

Të ftuar në mbledhjen e sotme janë zëvendësministri i Mbrojtjes, zoti Petro Koçi, sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, zonja Alba Thoma, drejtoresha e Inspektimit të Agjencisë së Kontrollit Shtetëror të Eksportit, zonja Gentjana Milkani, dhe zonja Erjola Karagjosi, përgjegjëse e sektorit në Drejtorinë e Legjislacionit në AKSHE, dhe Genti Cani, drejtor i Analizës së Riskut dhe Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Zoti Cani, ftesa juaj ishte me kërkesë të zotit Vullnet Sinaj, relatori i çështjes, pavarësisht se nga ministria morëm konfirmimin se projekti është diskutuar edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, si një institucion të cilit ky projektligj i ngarkon detyrime.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1 “Qëllimi”.

Relatori a ka ndonjë vërejtje?

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2 “Përkufizimet”.

Vullnet Sinaj – Unë mendoj se duhen informuar edhe kolegët që nuk kanë qenë radhën e parë. Bëhet fjalë për ndryshimin e ligjit për eksportin dhe importin e mallrave ushtarake, por edhe të disa mallrave që janë për përdorim të dyfishtë, që mund të përdoren edhe për ushtrinë, por që kanë edhe përdorim tjetër, mund të jenë mallra, si, për shembull, lëndët helmuese luftarake ose të dëmtimit në masë. Në këto raste Ministria e Mbrojtjes ka autoritetin e kontrollit shtetëror të eksporteve, i cili bën një listë të këtyre produkteve dhe ia dorëzon doganës. Të gjitha subjektet që merren me eksportin dhe importin janë të licencuara sipas licencave që dalin nga Kontrolli Shtetëror i Eksporteve. Kështu që çdo gjë është nën kontroll, është një ligj që është punuar nga Departamenti Amerikan dhe komuniteti europian. Është punuar dy vjet me këtë ligj dhe ka dalë një draft i ri.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Vazhdojmë me nenin 2.

A keni ndonjë vërejtje për nenin 2? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, është një nen i gjatë, përmban përkufizime, të cilat janë bërë sipas rregulloreve ndërkombëtare.

Neni 3 “Fusha e veprimit dhe përjashtimit”.

A keni ndonjë vërejtje për nenin 3? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Parimet e transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara”.

A keni ndonjë vërejtje? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 “Metodat e zbatimit të politikës për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”.

A keni ndonjë vërejtje? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 6 “Kompetencat për kontrollin e transferimit ndërkombëtar të mallrave”.

A keni ndonjë vërejtje? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 “Shkëmbimi i të dhënave në procesin e kontrollit shtetëror të transferimeve ndërkombëtare”.

A keni ndonjë vërejtje? Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 8.

Këtu unë kam një pyetje për punonjësit e ministrisë: te pika 2 e këtij neni thuhet se për punonjësit e AKSHE-së vlen detyrimi ruajtjes së sekretit ose mbrojtjes së të dhënave edhe pas përfundimit të detyrës për sa kohë vlen ky detyrim?

Petro Koçi- Është pa kufizim.

Ermonela Felaj – Pyetja ime ishte për të sqaruar kohën, sepse, kur ju i ruani të dhënat për licencimet, eksportimet, importet dhe të gjitha certifikatat për 10 vjet nga data e lëshimit, a ka sens që të ruhen këto të dhëna për më shumë se 10 vjet? Pra, kjo pikë ka një detyrim për ta sqaruar, sepse detyrimi shkon edhe pasi mbaron detyrën. Pra, deri në fund të jetës, subjekti është i detyruar që t’i ruajë ato të dhëna. A mendoni se duhet vënë ndonjë afat?

Petro Koçi – Nëse do të ishte dy vjet, atëherë i bie që pas periudhës 2- vjeçare subjekti të kishte lejen për të komunikuar ose dëshmuar lidhur me këto gjera. Flas jo në anën institucionale, sepse nëse do të ketë një proces penal, ai sigurisht është i detyruar që brenda një kuadri ligjor të përcaktuar të dëshmojë, por kjo mbetet një detyrim i përhershëm.

Xhemal Gjunkshi – Zonja kryetare, edhe unë shtroj pyetjen: këto dokumente dhe ky aktivitet, siç është në ligj, duhet të lihet, apo të ketë një kufizim? Pse e shtroj këtë pyetje? Sepse ne kemi dokumente të klasifikuara, kemi dokumente sekrete dhe tepër sekrete, të cilat kanë një afat kohor ruajtje dhe dekonspirimi. Ne kemi edhe arkivat që pas iks vitesh hapen, pra në këtë aspekt unë nuk jam kundër kësaj që këtu të ketë një privatësi dhe të respektohet, por, duke pasur parasysh punën e përditshme që ne bëjmë dhe që ju ushtroni, përfshi këtu edhe dokumentet e klasifikuara të NATO-s, mbase ia vlen ta rishikoni vënien e një afati kohor.

Petro Koçi – Bëhet fjalë për të dhënat personale të subjekteve, nuk bëhet fjalë për të tjera. Pra, ka legjislacion për mbrojtjen e të dhënave personale, konform atij legjislacioni është bërë edhe pika 2 e nenit 8. Pra, mbrojtja e të dhënave personale është një detyrim i përhershëm.

Ermonela Felaj- Atëherë, të shtojmë: “ky është detyrim edhe gjatë, edhe pas përfundimit të detyrës sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale”. Të shtojmë këtë pjesë dhe jemi më korrektë. Vendosim legjislacionin si referencë dhe besoj se jemi në rregull.

Atëherë, a jeni dakord me këtë shtesë të vogël në nenin 8?

Kush është dakord me nenin 8? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Neni 9 “Autoriteti shtetëror për kontrollin e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake, artikujve, teknologjive me përdorim të dyfishtë”.

A keni ndonjë vërejtje?

Unë kam një propozim për pikën 4 të nenit 9 ku thuhet: “Këshilli i Ministrave përcakton me vendim organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e AKSHE-së dhe afatet”. Duke iu referuar gjuhës që është përdorur në projekt, a nuk do të ishte më korrekt që të thoshim “Këshilli i Ministrave miraton”, sepse propozimi besoj do të vijë nga struktura përkatëse e Ministrisë së Mbrojtjes?

Kush është dakord me nenin 9? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 10 “Lista e mallrave të kontrolluara objekt i kontrollit të transferimit ndërkombëtar”.

Kush është dakord me nenin 10? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Nenin 11 “Kontrolli mbi mallrat dhe artikujt që nuk janë të përfshirë në listën e mallrave të kontrolluara”.

A keni vërejtje për këtë nen?

Në fakt, për të qenë konsistent në shkrimin e ligjit, unë kam një sugjerim, meqenëse diku e keni shkruar me shkurtime AKSHE, diku të plotë, të mbajmë të njëjtën linjë, ta shkruajmë të plotë.

Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 12 “Kriteret për vlerësimin e riskut, transferimeve ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara”.

Pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 13 “Kriteret e përgjithshme për licencimin”.

Unë kam një sugjerim, por dua edhe mendimin e ministrisë, ju këtu shkruani se një ndër shkaqet që do të pengonte licencimin e një subjekti është rasti kur ndaj tij ka filluar një procedim penal lidhur me sigurinë kombëtare. Për t’u përshtatur edhe në kapitujt e Kodit Penal, besoj se do të ishte më mirë nëse do të shkruanim: “për veprat penale lidhur me procedimin penal, kundër rendit dhe sigurisë publike”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Regjistrimi për transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake”.

Kush është dakord me nenin 14?

Zoti Gjunkshi ka një sugjerim.

Xhemal Gjunkshi – Lidhur me certifikatën e regjistrimit, thuhet që ajo është e vlefshme për 3 vjet. Cili është kriteri që ju keni menduar që kjo certifikatë të ketë këtë afat kohor?

Gentiana Milkani– Faleminderit për pyetjen!

Në fillesat e veta të zhvillimit të aktivitetit të Autoritetit të Kontrollit të Shtetit të Eksporteve certifikata e regjistrimit lëshohet pa afat. Për mallrat ushtarake ky është procesi i parë në kuadër të fazave të licencimit. Lëshohet certifikata e regjistrimit, pastaj është detyrimi i subjektit për t’u pajisur me licencë. Fakti që gjykojmë në përcaktimin e një afati vlefshmërie tre vjet ishte sepse konstatuam që në rastet kur lëshohet pa afat kishim ndryshime të gjendjes dhe statusit të përfaqësuesve të shoqërisë, kështu që gjykojmë që të linim një afat të përcaktuar për të bërë një riveifikim me institucionet e inteligjencës dhe të tjerat, si kompanitë dhe përfaqësuesit e tyre.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Atëherë kush është dakord me nenin 14? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 15 “Kontrolli i sigurisë”.

A ka vërejtje për këtë nen?

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 16 “Paraqitja e një kërkesë të re për regjistrim”.

Kush është dakord me nenin 16? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Licenca për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake”.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Transiti i mallrave ushtarake”.

Kush është dakord me nenin 18?

Po, zoti Murrizi ka një pyetje për nenin 18.

Myslym Murrizi – Për çfarë transiti bëhet fjalë? A janë subjekte vendase apo të huaja?

Petro Koçi – Besoj se është fjala për të gjitha llojet e subjekteve. Është standard ndërkombëtar, duhet të ketë licencë nga AKSHE-ja, që të mund të bëjë transit, për shembull nga Durrës të shkojë në Morinë, nuk mund të kalojë pa kontroll shtetëror.

Ermonela Felaj –Atëherë, kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 19 “Masat e sigurisë”.

A ka ndonjë vërejtje?

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 20 “Autorizimi për transferimin ndërkombëtar të mallrave ushtarake që lidhen me sekretin shtetëror”.

A ka ndonjë vërejtje? Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 21 “Licenca për transferimin ndërkombëtar të artikujve me përdorim të dyfishtë”.

A ka ndonjë vërejtje? Kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 22 “Transiti i artikujve me përdorim të dyfishtë”.

A ka ndonjë vërejtje? Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 23 “Shërbimet ndërmjetësuese”.

A ka ndonjë vërejtje?

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 24 “Asistenca teknike”.

A ka ndonjë vërejtje?

Kush është dakord me nenin 24? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 25 “Organizimi i programit të përputhshmërisë së brendshme në subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara”.

A ka ndonjë vërejtje?

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26 “Lëshimi i licencave, autorizimeve ose certifikatave”.

A ka ndonjë vërejtje?

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 27 “Afati kohor për shqyrtimin e një aplikimi për licencë apo certifikatë”.

A ka ndonjë vërejtje?

Xhemal Gjunksi- Unë kam një mendim në lidhje me dhënien e licencës, te neni 26.

Ermonela Felaj– Nenin 26 e votuam, por thuaj mendimin tënd!

Xhemal Gjunksi – Afati kohor sa është? Sepse themi që marrja e certifikatës ka një afat kohor 3 vjet, ndërkohë që jepet licenca. Për sa kohë është e drejta e ushtrimit të...?

Ermonela Felaj – 27 është afati kohor...

Xhemal Gjunksi – Sa e ka?

Ermonela Felaj - Për çdo lloj aplikimi kemi afate të ndryshme.

Xhemal Gjunksi – Sa shkon maksimalja?

Ermonela Felaj – 45 ditë.

(Diskutime pa mikrofon)

Xhemal Gjunksi – E licencës, për ta përdorur?

Ermonela Felaj - Për të vlerësuar një aplikim dhe më tej për të plotësuar dokumentin përkatës.

Xhemal Gjunksi – Jo, doja të dija sa është afati i përdorimit të licencës?

Ermonela Felaj – Zonja Milkani apo zonja Karagjozi, kush do të përgjigjet nga ju?
Zonja Milkani.

Gentiana Milkani – Afatet që përmenden në...

Xhemal Gjunksi – Të përdorimit...

Gentiana Milkani – Neni 27 përcakton afatet e shqyrtimit, ndërkohë pak më poshtë në material janë të përcaktuara afatet e vlefshmërisë për licencat për mallrat ushtarake dhe për licencat për mallrat me përdorim të dyfishtë.

Ermonela Felaj – Neni 27 flet për afatet për të shqyrtuar një aplikim, të jemi të qartë, sepse sipas natyrës së aplikimit janë edhe afatet.

Xhemal Gjunksi – Sa janë afatet e licencimit, të përdorimit të licencës?

Ermonela Felaj – Ajo është e përcaktuar te neni tjetër.

Xhemal Gjunksi – Sipas llojit të licencave, ka edhe afate 1-vjeçare.

(Diskutime pa mikrofon)

Gentiana Milkani – Për mallrat me përdorim të dyfishtë janë: për licencat individuale 1 vit, për globalet 2 vjet dhe për licencat e përgjithshme 3 vjet.

Ermonela Felaj – Për këtë nen apo kur të vijmë te neni përkatës, që të jemi më korrekt.

A jeni dakord me nenin 27?

Po, zoti Harusha, zoti Sina dhe Dusha. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 28 “Ekspertiza teknike gjatë vlerësimit”. Kush është dakord me nenin 28?
Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 28.

Neni 29 “Refuzimi i një aplikimi”. Kush është dakord me nenin 29 të projektit? Kundër?
Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 29.

Kalojmë te neni 30 “Pezullimi i licencave, autorizimeve dhe certifikatave”. Pra, është rasti kur Autoriteti Shtetëror i Eksporteve vendos për pezullimin e dokumentacioneve që ka lëshuar përkundrejt subjekteve të ndryshme.

Kush është dakord me nenin 30? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 30.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, ngrijeni dorën...

Flamur Noka – E kemi ngritur dorën...

Ermonela Felaj – Jo, nuk e keni ngritur, se unë shoh.

Dakord, në rregull.

Kush është kundër? 3 kundër.

Vazhdojmë me nenin 31 “Shfuqizimi i licencave, autorizimeve dhe certifikatave”.

Zoti Sinaj, keni vërejtje për këtë nen?

Jo.

Kush është dakord? Kundër? Sekretaria t’i marrë shënim. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 31.

Neni 32 “Mbajtja e të dhënave”, që është detyrimi që ka AKSHE për të ruajtur të dhënat për 10 vjet. Kush është dakord me përmbajtjen?

(Diskutime pa mikrofon)

Thamë se do ta vëmë sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, sepse ai detyrimin e ka sipas legjislacionit.

(Diskutime pa mikrofon)

Detyrimin që ka institucioni.

Petro Koçi – Çdo punonjës ka detyrimin e përjetshëm sipas projektit që të mos komunikojë të dhënat personale. Pra, ky është një dokumentacion, 10 vjet është arkivi dhe më pas arkivi, sigurisht nëpërmjet zbatimit të rregullave, nuk e ruan më.

Jeni dakord me nenin 32? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33 “Parimet e nënshkrimit të kontratave në vendet e huaja për transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara”. Kush është dakord me nenin 33? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 33.

Neni 34 “Kontrolli shtetëror ndaj kryerjes së negociatave për nënshkrimin e një marrëveshjeje ekonomike apo kontrate me vendet e huaja”.

Kush është dakord me nenin 34? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 34.

Neni 35 “Kontrolli shtetëror mbi përdorimin e fundit të mallrave”. Ky është një nen me 8 paragrafë.

A keni vërejtje për këtë nen, zoti relator?

Vullnet Sinaj – Jo, nuk kam.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 35? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Ju lutem, shënoni kolegët që kanë votuar kundër.

Miratohet neni 35.

Neni 37 “Detyrimet e mbajtjes së të dhënave për subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara”. Për këtë nen gjatë diskutimit në parim nuk kemi pasur pyetje dhe diskutime, prandaj kush është dakord? Kundër? Kolegët e opozitës janë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 37.

Neni 38 “Detyrimet për raportim për subjektet e përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara”. Kush është dakord me nenin 38? Kundër? Deputetët e opozitës u deklaruan kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 38.

Neni 39 “Parandalimi i shkeljes së legjislacionit dhe përgjegjësia për kontrollin shtetëror të eksporteve”. A ka ndonjë sugjerim relatori? Nuk ka.

Unë kisha një sugjerim vetëm për pikën 4 të këtij neni. Ju thoni se ka të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se po bëhen tentativa, që tregojnë se po kryhet një vepër penale ose kur ajo është kryer nga ndonjë subjekt, autoriteti ka detyrimin të njoftojë autoritetet penale. Besoj se njoftimi duhet të jetë i menjëhershëm sapo AKSHE vihet në dijeni, sepse është një detyrim që e keni si çdo subjekt tjetër për të kallëzuar veprën penale në organin penal, por besoj se edhe koha ka vlerën e saj. Pra, jeni dakord të shtojmë fjalën “menjëherë”?

Kush është dakord me nenin 39 së bashku me shtimin e fjalës së propozuar? Kundër? Opozita kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 39.

Neni 40 “Përgjegjësia e personave dhe subjekteve të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave për shkelje të legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve”. Ky nen ka vetëm një paragraf, është një nen deklarativ. Kush është dakord me përmbajtjen e këtij neni? Kundër? Opozita është kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 40.

Neni 41 përcakton të gjitha rastet kur shkelje të ndryshme të këtij ligji mund të përbëjnë kundërvajtje administrative, por jo vetëm, mund të jetë edhe vepër penale sipas rastit. Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 41? Kundër? Opozita është deklaruar kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 41.

Neni 42 “Gjobat dhe ndëshkimet administrative për shkelje të legjislacionit në fushën e kontrollit të eksporteve”. Nuk e di a ka ndonjë pyetje apo vërejtje nga kolegët?

Zoti Sinaj, keni ndonjë gjë?

Vullnet Sinaj – Jo, nuk kam.

Ermonela Felaj – Zoti Gjunkshi, keni ndonjë gjë? Pra, flitet për gjobat, ndëshkimet administrative për shkelje të legjislacionit në fushën e kontrollit të eksporteve.

Faleminderit!

Do të kisha një pyetje për zotin Koçi ose për përfaqësuesit e AKSHE-s. Në raport me ligjin e vitit 2007, si ka ndryshuar niveli i gjobave? Unë shoh që hapësira midis minimumit dhe maksimumit është shumë e lartë, 500 mijë me 5 milionë dhe është kështu sipas çdo rasti. A mund të na e sqaroni se çfarë do të thotë kjo, janë të njëjtat sanksione si në ligjin e shkuar, apo i keni rritur? Si qëndrojnë në raport minimumi me maksimumin në secilin ligj.

Zonja Karagjozi, e ka fjalën.

Eriola Karagjozi – Në krahasim me ligjin e mëparshëm kemi një rritje shumë të lehtë të kufirit të gjobave.

Ermonela Felaj – Me sa?

Eriola Karagjozi - Për shembull, në rastin e parë ka qenë nga 500 mijë deri në 2 milionë lekë. Në pikën “a” thuhet: “Për shkelje të parashikuara në nenin 41 nga 500 mijë deri në 2 milionë lekë”, e cila është bërë “nga 500 deri në 5 milionë lekë”.

Ermonela Felaj – A mund të na jepni një arsye pse jeni detyruar të propozoni ndryshimin e gjobave?

Eriola Karagjozi – Arsyeja është se ka shkelje që kanë të bëjnë me mallra sensitivë, që do të thotë edhe pasojat e shkeljeve janë të rëndësie të veçantë dhe për këtë arsye është gjykuar e tillë.

Ermonela Felaj - A keni pasur ju raste të shtuara, kur kanë ndodhur shkelje të tilla dhe ju mendoni se rritja e gjobave do të jetë me efekt të tillë apo...?

Eriola Karagjozi - Po, kemi pasur raste të shkeljeve, por ndoshta kjo do t'i sensibilizojë edhe subjektet që të jenë pak më të përgjegjshëm për këtë lloj veprimtarie.

Ermonela Felaj – A keni ndonjë shpjegim tjetër?

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Unë besoj se kjo ka lidhje me frymën e përgjithshme të rritjes së ndëshkueshmërisë...

Ermonela Felaj – Apo të Rregullores...

Petro Koçi - ... ndaj shkeljeve, krimit, kundërvajtjeve, kështu që është më shumë në frymën e përgjithshme.

Ermonela Felaj – E kuptova, megjithatë do të doja t'i ftoja kolegët, sepse realisht kemi diskutuar edhe për projekte të tjera, ku hapësira shumë e gjerë midis minimumit dhe maksimumit gjithmonë bëhet problematike. Në qoftë se nuk ka arsye madhore që t'ju detyrojnë të rrisni gjobat, nuk e di se si e shohin këtë edhe kolegët, prandaj do të doja të dija nëse mund të mbahet i njëjti nivel gjobash që ka qenë.

Vullnet Sinaj – Në qoftë se i referohemi pikës “a” për atë gjobë thuhet: “Kryerja e transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara në mungesë të licencës apo certifikatës sipas procedurave ligjore”. Kjo nuk ka kuptim. Është normale ajo vlerë gjobe, sepse ai shkon për ndjekje penale në qoftë se bën transportim të këtyre mjeteve pa licencë.

Ermonela Felaj – Në rregull, në qoftë se edhe kolegët e mendojnë kështu!

Kush është dakord me nenin 42? Kundër? Kolegët e opozitës. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 42.

Neni 43 “Ankimi kundër vendimeve të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve”.

Po, zoti Alibeaj, ka një pyetje për nenin 43.

Enkelejd Alibeaj – Ju kërkoi ndjesë për ndërhyrjen!

Kam përshtypjen se ky është neni më i rëndësishëm i ligjit. Në fakt, çdo nen, i cili përcakton regjimin e monitorimit të veprimtarisë administrative nga gjykata, kontrolli gjyqësor është garancia e vetme që jepet për gjithë ligjin. Pra, në qoftë se bie kjo garanci, bie edhe i gjithë ligji, qëndron kjo garanci, ligji është konsistent, edhe subjektet private kanë garancitë e tyre.

Ju keni parashikuar në fjalinë e parë të nenit 43 që ekziston e drejta e ankimit. Edhe në qoftë se nuk e parashikoni ju, kjo parashikohet në Kushtetutë, por ajo që unë shoh interesante, por më shumë problematike, është fjalia e dytë. Ju thoni se keni parashikuar që për çdo vendim heqjeje, shfuqizimi të licencave apo autorizimeve, për çdo dëm eventual që sillet në veprimtarinë normale të subjekteve private, subjekti privat nuk ka të drejtë ta kërkojë minimalisht dëmin. Me aq sa unë kujtoj, ka një parashikim kushtetues, neni 44 i Kushtetutës, në të cilin është shprehur që marrëdhënia e subjekteve private me administratën publike është e tillë që në minimumin e minimumit subjektet private kërkojnë dëmin në maksimum, kërkojnë rivendosjen në të njëjtën situatë, por nën këtë barazh minimum, pra shpërblimin e dëmit nuk mund t'ia mohosh. E para.

E dyta, e zëmë se kërkohet një kufizim i kësaj të drejte. Si e justifikoni ju këtë duke u bazuar në nenin 18 të Kushtetutës?

E treta, legjislacioni shqiptar ka parashikuar deri edhe mbajtjen e përgjegjësisë së administratës publike edhe për dëme jashtëkontraktore, ka një ligj për këtë, besoj se ju jeni në dijeni, e jo më për këto marrëdhënie, të cilat janë të rregulluara deri në njëfarë mënyre me një marrëdhënie administrative publike në këtë rast. Dua të di se çfarë garancie u jepni ju këtyre subjekteve private? Tani që nuk ka Gjykatë Kushtetuese, për mendimin tim kjo dispozitë është antikushtetuese. E para.

E dyta. Ju u mohoni edhe të drejtën për aksesin efektiv në gjykatë, ai bën padi, por nuk ka çfarë të kërkojë, pasi gjykata i thotë mirë se ke ardhur, por ligji më thotë të mos të të jap asgjë. Si e justifikoni ju këtë parashikim?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Kush e do fjalën nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes?

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Shqetësimi është i drejtë dhe mendoj se është e justifikuar ndërhyrja e deputetit, por këtu bëhet fjalë për raste tepër të veçanta, pra kur merren veprime, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e interesave kombëtare dhe garantimin e përmbushjes së detyrimeve

ndërkombëtare të shtetit, nuk bëhet fjalë për një veprimtari të zakonshme. Në fjalinë e parë thuhet: “Vendimi i marrë nga AKSHE për të vendosur gjoba, pezulluar, revokuar licencë, certifikatë, autorizim e të tjera, mund të ankimohej në përputhje me Kodin e Procedurës Administrative...”

Ermonela Felaj - Deri këtu është në rregull, sepse është një e drejtë e përcaktuar në kod...

Petro Koçi – I vetmi kufizim është kur cenohet interesi i sigurisë kombëtare. Pra, bëhet fjalë për raste që mund të ndodhin ose mund të mos ndodhin fare, tepër të veçanta, kur ne kemi detyrime ndërkombëtare, të cilat duhet t’i respektojmë, bëhet fjalë ndoshta për subjekte, të cilat mund të kenë marrë një licencë, por ndërkohë mund të ketë pasur zhvillime të tjera, të cilat do ta detyrojnë AKSHE-n të marrë këtë lloj vendimi.

Pra, jemi në këtë lloj situatë hipotetike, kur cenohet interesi kombëtar...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju e keni parë te dispozitat e tjera, dikush merr një licencë apo një autorizim, por nëse Këshilli i Sigurimit vendos që ndaj këtij shteti, ku vepron ky subjekt, do të merren sanksione, atëherë atij i pezullohet licenca e të tjera.

Ermonela Felaj – Në fakt, edhe unë aty do ta bëja ndërhyrjen, zoti Koçi, për sa i takon pyetjes që bëri zoti Alibeaj. Ne sapo kaluam nenin 30 dhe nenin 31, në të cilët bëhej fjalë për pezullimin dhe shfuqizimin dhe në secilin nga këto raste, për shembull, për pezullimin thuhet: “Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve pezullon licencën, autorizimin ose certifikatën që ka lëshuar kur Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara apo një organizatë tjetër ndërkombëtare, ku vendi ynë do të bënte pjesë, vendos masa kufizuese ndaj vendit për të cilin janë lëshuar këto licenca e me radhë”. Pra, në këtë rast nëse është pezulluar për këtë shkak për humbjet që do t’i vinin atij vendi nga ky veprim, për këtë nuk mban përgjegjësi shteti shqiptar...

Petro Koçi – Bëhet fjalë për humbjet e subjektit...

Ermonela Felaj – Në fakt, e njëjta fjalë është vendosur në nenin 30, paragrafi i tretë, prandaj ju ftoj t’i shohim edhe një herë, edhe pse i miratuam, neni 31, paragrafi i dytë, pasi flitet për rastet e pezullimit dhe të shfuqizimit është vënë kjo pjesa deklarative në fund: “Republika e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi ligjore për dëme të mundshme të shkaktuara nga pezullimi i licencës në rastet që parashikon neni në fjalë”. E njëjta gjë është thënë edhe në nenin 31, prandaj shoh se neni 43 nuk bën as më shumë dhe as më pak, por përsërit të njëjtat fjali që kanë këto dy nene...

(Diskutime pa mikrofon)

Për paragrafin e fundit e kam fjalën edhe unë. Në këtë paragraf thuhet: “Shteti shqiptar nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj një subjekti për humbje të shkaktuara për shkak të pezullimit apo shfuqizimit të licencës, autorizimit, certifikatës dhe garancisë shtetërore, nëse këto veprime janë ndërmarrë për qëllime të mbrojtjes së interesave kombëtare dhe garantimit të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare të shtetit...”

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëro!

Pra, për këtë nuk mban përgjegjësi, kur Këshilli i Sigurisë Ndërkombëtare vendos kufizime ndaj vendit për dëmet që mund t’i vijnë atij, pse duhet të mbajmë ne përgjegjësi? Unë besoj se këto janë detyrime ndërkombëtare dhe nuk kemi pse ta penalizojmë vendin tonë për një gjë të tillë. Megjithatë, meqenëse zoti Alibeaj e ngriti këtë diskutim dhe kërkon të rindërhyjë, fjala për të.

Enkelejd Alibeaj – E kuptoj logjikën që është e saktë, por nuk kuptoj gjuhën që është totalisht e pasaktë. Në fakt, gjuha është ajo, e cila nesër do të shkojë nëpër gjykata apo instanca të tjera. Ju thatë se është përsëritur në dispozita të tjera, shumë mirë, nëse është përsëritur në dispozita të tjera si neni 30 apo neni 31 hiqeni që këtu, pse e përsërisni? E para.

E dyta, ju e dini fare mirë që e drejta për të shkuar në gjykatë, e drejta për të kërkuar dëmshpërblim nga administrata publike është e parashikuar në Kushtetutë, neni 44. Unë e di se të flasësh për Kushtetutën është pak arkaike, e kuptoj këtë histori, po kështu Kushtetuta parashikon edhe raste kur mund të kufizohet një nga liritë apo të drejtat e saj dhe ju e dini fare mirë, neni 18 i saj. Ju po pretendoni, qeveria në këtë rast, që me dy justifikime, nëse është ndërmarrë për qëllime të mbrojtjes së interesave kombëtare. Më falni, por çfarë veprimi është ai që ndërmerret nga qeveria që nuk është për mbrojtjen e interesave kombëtare? Të gjitha janë. Asnjë s’mund të jetë për mbrojtjen e interesave kombëtare, është e natyrshme që në çdo rast futet dhe inkuadrohet në këtë hipotezë. Po kështu edhe në rastin tjetër.

Me këto dispozita jo vetëm që i keni tejkaluar nenet 18, 42 dhe 44 të Kushtetutës, por praktikisht u keni mohuar aksesin efektiv në gjykatë subjekteve private. Kjo është e gjitha!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Së pari, Kushtetuta është Bibla dhe nuk është arkaike të flasësh për zbatimin e Kushtetutës! Sido që të vijë puna, pavarësisht përmbajtjes së këtij ligji, çdo institucion shtetëror

ka si udhërrëfytes të parën Kushtetutën dhe ligje të tjera më pas, të cilët, siç e dini, me kuorume të veçanta janë më të fuqishme sesa ky ligj, i cili është me shumicë të thjeshtë votash.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jemi duke bërë atë diskutim tani!

Jo çdo gjë është interes kombëtar! Ka interesa kombëtare që janë jetike, ka interesa me rëndësi strategjike, ka edhe interesa personale etj. Bëhet fjalë kur cenohet siguria kombëtare dhe kur jemi të detyruar të veprojmë për shkak të detyrimeve ndërkombëtare. Pra, nëse një subjekti, i cili merret me transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake apo të atyre me përdorim të dyfishtë, është i detyruar që t'i ndërpritet licenca, autorizimi etj., për shkak të këtyre dy gjërave, nuk ka arsye që shteti shqiptar t'u paguajë dëmshpërblim. Kjo është ideja. Por, nëse ky pezullim vjen për arsye të tjera, shteti është i detyruar t'ua paguajë një më një.

Ermonela Felaj – Pezullimi dhe shfuqizimi janë përcaktuar në mënyrë shteruese në secilin nga nenet.

Petro Koçi –...por nëse ai subjekt na cenon interesin kombëtar, ku di unë, mund të jetë veprimtari spiunazhi etj., etj., sigurisht që shteti nuk ka detyrime për to. Nëse vendoset një sanksion nga Këshilli i Sigurimit, shteti shqiptar nuk ka arsye që t'i paguajë detyrimet një subjekti, i cili ka marrë një licencë për iks vend që ndërkohë,...

Ermonela Felaj – Që mbrapa është shfuqizuar.

Petro Koçi –... gjërat kanë ndryshuar, mund të ketë filluar lufta etj., etj. Nuk ka arsye! Këtë kuptim ka ky nen. Mund të ishte si pikë e dytë, ndoshta ka të drejtë të shprehja e gjuhës, te ky nen, dhe ndoshta mund të kishte nevojë për një saktësim të mëtejshëm, por neni këtë kuptim ka. Nuk ka lidhje me diskutime të tjera të natyrës politike.

Vullnet Sinaj - Mund të bëj një pyetje?

Po te ligji i mëparshëm nr. 9707, datë 5.04.2007, si është parashikuar ky nen?

Zonjë - Nuk ka qenë i parashikuar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, zoti Sinaj, përdorni mikrofonin nëse do të flisni!

(Diskutim pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – ...mendoj që edhe situata në botë dhe në Europë nuk është e njëjtë me atë që ka qenë në vitin 2007. Veprimet terroriste kanë detyruar Europën që të marrë masa. Edhe ne që aderohet në të gjitha konventat e përbashkëta duhet të marrim masa sa më shtrënguese për të mos

pasur situata të tilla në Shqipëri, në vendet e rajonit apo në Europë, ku do të donim të bëheshim pjesë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Diskutimi ishte më shumë juridik sesa teknik, megjithatë, meqenëse kolegët i dëgjuan të dyja qëndrimet, edhe nga opozita, edhe nga maxhoranca meqenëse nga zoti Koçi pati një propozim, që fjalë e dytë e këtij neni të kalojë si paragraf i dytë, për të kuptuar që bëhet fjalë jo për parimin, sepse cilido shkon në Gjykatën Administrative dhe ankohet, cilido shkon në Gjykatën Civile dhe kërkon shkaktimin e dëmit, këto janë të drejta të pamohueshme, ndërkohë që situata që përshkruan fjalë e dytë është e veçantë.

Petro Koçi – Kjo që thotë zoti Alibeaj me të drejtë “Për mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare”, mund të jetë më e qartë.

Ermonela Felaj – Atëherë kush është dakord që të votohet neni 43, sipas propozimit që bëri zoti Koçi, duke kaluar fjalë e dytë, paragrafi i dytë edhe me korrigjimin e vogël brenda fjalisë? Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet neni 43!

Kalojmë në nenin 44 “Autoriteti për vendosjen e gjobave për shkeljet e legjislacionit në fushën e transferimeve të mallrave ushtarake”.

Kemi vërejtje për këtë nen? Nuk kemi! Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 45 “Financimi i veprimtarisë së kontrollit shtetëror të eksporteve”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 46 “Mbledhja e tarifave për regjistrimin dhe nxjerrjen e dokumenteve”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Po, faleminderit! Opozita është kundër! Abstenime nuk ka!

Kalojmë te pjesa e fundit e projektligjit “Dispozitat kalimtare dhe të fundit”.

Neni 47. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 48.

Petro Koçi –Do të doja mirëkuptimin e komisionit që te fjalë e parë, “Dispozitat”, neni 48, afati të jetë brenda 6 muajve, jo brenda 3 muajve.

Ermonela Felaj – Kërkoni që të ndryshojmë afatet?

Petro Koçi – Pra, në qoftë se ligji kalon tani, i bie të jetë edhe periudha e gushtit, kështu që do të duhet 6 muaj besoj.

Ermonela Felaj – Dakord! Besoj se është e logjikshme!

Kush është dakord me propozimin që bëri zoti Koçi për nenin 48, paragrafi i parë, afati i parë të bëhet 6 muaj?

Vullnet Sinaj – Dua të bëj një ndërhyrje të vogël: te neni 48, pika 2, thuhet: “Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve miraton akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji, të parashikuara në pikën 2 të nenit 14, në pikën 3 të nenit 25 dhe në pikën 3 të nenit 26” dhe me radhë. Anashkalohet neni 36, që ka të bëjë me doganat, ku mendoj se duhet bashkëpunimi i Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në këtë rast duhet që Ministria e Mbrojtjes të parashikojë edhe akte nënligjore për këtë nen, të bashkëpunimit të Ministrisë së Mbrojtjes me Doganën, pasi Dogana është një pikë shumë e rëndësishme. Në ligj parashikohet që Ministria e Mbrojtjes i lë Doganës listën e artikujve të eksportit ushtarak.

Mendoj që pjesa e nenit 36 duhet shtuar për të qenë më të sigurt ne si shtet për mallrat që tranzitohen apo që kalojnë nëpër dogana. Pika e doganës është shumë e rëndësishme. Nuk është parashikuar...

Ermonela Felaj – Në fakt, neni 36 nuk parashikon asnjë detyrim të shprehur për doganat që të detyrohen të nxjerrin ndonjë akt nënligjor. Ato marrin detyrime nga neni 36 i ligjit.

Vullnet Sinaj – Kryerja e detyrave përcaktohet në pikën 1 të këtij neni. Te pika 3, autoriteti doganor mund të kërkojë asistencë të Autoritetit të Kontrollit të Shtetëror të Eksporteve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm asistencë, por mund të dalë diçka edhe për doganën.

Ermonela Felaj – Ne kemi të ftuar në komision përfaqësuesin e doganës. A mund t’ia lëmë fjalën zotit Genti Cani, meqenëse ka ardhur enkas për këtë gjë?

Genti Cani – Për të sqaruar pjesën e asistencës, gjatë ushtrimit të kontroleve doganore, doganieri mund të mos jetë në gjendje që gjatë ushtrimit të kontrollit të identifikojë nëse një produkt i caktuar me karakteristikat që paraqet është apo jo me përdorim të dyfishtë. Në të tilla raste, dogana pezullon çlirimin e mallit, njofton autoritetin kompetent, i cili ofron asistencë për identifikimin nëse produkti në fjalë plotëson apo jo kushtet e caktuara.

Ne si dy institucione, gjithsesi, kemi një memorandum bashkëpunimi për shkëmbime informacionesh, pikat e kontaktit dhe gjithçka tjetër.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Cani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sina, ju lutem, që të jemi korrektë për regjistrim, kur merrni fjalën, ndizni mikrofonin, në mënyrë që pyetja juaj të regjistrohet.

Vullnet Sinaj – Në qoftë se ju si doganë jeni të qartë për të zbatuar këtë ligj të rëndësishëm në bazë të asaj që është shkruar këtu, dakord. Mendova se kishit nevojë për më shumë informacion, për më shumë rregull, akte nënligjore apo udhëzime nga Ministria e Mbrojtjes për punën e eksporteve dhe importeve të mallrave ushtarake apo me veprim të dyfishtë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Besoj se zoti Cani ishte i qartë.

Sidoqoftë, doganat kanë ligjin e tyre, Kodin Doganor dhe do të zbatojnë atë. Në rast se pastaj do të ndeshin vështirësi, në përcaktimin e natyrës së mallrave, ose detaje të tjera që kanë të bëjnë me fushën e veprimtarisë së AKSHE-së, ligji e detyron që të bashkëpunojë me të për këtë gjë.

Atëherë, i rikthehem nën 48 edhe një herë. Kush është dakord me amendimin që bëri në paragrafin e parë, zoti Koçi?

Vullnet Sinaj – Më falni, zonja kryetare, se më kaloi! Te neni 48 kisha një ndërhyrje.

Duke lexuar relacionin, zoti zëvendësministër, thoni që është një domosdoshmëri kalimi i këtij ligji. Unë nuk jam dakord që kjo të kalojë në afatet 6-mujore, sepse institucionet shtetërore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Jo, është për nxjerrjen e akteve nënligjore, se i takojnë dy muaj pushim.

Xhemal Qefalia - Është muaji gusht, por nuk do të thotë se është pushim. Administrata është në punë dhe, meqë është muaji gusht, nga 3 muaj ta bëjmë 6 muaj, sikur gushti ka fuqinë e tri muajve bashkë. Kështu që unë mendoj që është kohë optimale e mjaftueshme. Gjithsesi, është në dorën tuaj për ta votuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Për të qenë konstruktivë me zotin Qefalia, mbetemi te 4 muaj? Kështu që po ua heqim edhe muajin e pushimeve, dhe gjithsesi i keni 3 muaj.

Petro Koçi - Edhe për aktet nënligjore duhet bërë patjetër konsultimi me publikun dhe me grupet e interesit. Pra, është e vështirë që kjo të bëhet brenda 3 muajve. Po të ishte për 4 muaj, e linim 3 muaj.

Ermonela Felaj – Dakord, se kolegët janë dakord që t’i keni 6 muaj.

Kush është pro për nenin 48? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 49 “Shfuqizimi i ligjit që ka vepruar deri tani”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Hyrja në fuqi e këtij ligji do të bëhet 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare. Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim?

Miratimin në tërësi do ta njoftojmë në një mbledhje tjetër, për shkak se ende nuk e kemi të depozituar raportin nga Komisioni i Integritetit. Meqenëse ky është një ligj që shoqërohet me një tabelë në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, pavarësisht se ne e kemi parë, por nuk është detyra jonë që ta shohim përputhshmërinë, por është detyrë e një komisioni tjetër. Në atë moment, do t’ju lutesha të ishit prezentë për të bërë votimin në tërësi dhe mandej kalimin e këtij projekti në seancën plenare.

Faleminderit për pjesëmarrjen! Punë të mbarë!

Petro Koçi - Faleminderit, zonja kryetare dhe gjithë anëtarëve të komisionit, për frymën ndërtuese në këtë mbledhje!

(Mungesë incizimi)

Sekretar
Euzheni Pengili

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Sekretare e komisionit
Antonela Veshi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.07.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Miratimi në tërësi i projektligjit “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””

Marrin pjesë :

Ermonela Felaj, Xhemal Qefalia, Pjerin Ndreu, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Anduel Xhindi, Ervin Salianji, Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj, Myslym Murrizi, Sadi Vorpsi dhe Vullnet Sinaj

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Luan Rama, Paulin Sterkaj, Flamur Noka dhe Endrit Brahimllari

Të ftuar:

Petro Koçi – Zëvendësministër i Mbrojtjes

Alba Thoma - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes

Gentiana Milkani - Drejtore e Inspektimit në AKSHE

Eriola Karagjosi - përgjegjëse sektori në Drejtorinë e Legjislacionit në AKSHE.

Genti Cani – Drejtor i Analizës së Riskut dhe Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Ermonela Felaj – Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që lidhet me amendimin e propozuar nga kolegu ynë, zoti Ndreu, për Kodin Rrugor, në nenin që bën fjalë për pezullimet e lejeve të drejtimit, konkretisht neni 127 i Kodit Rrugor.

Nga ana e iniciuesit të këtij amendimi propozohet, të gjithë kolegët kanë dokumentin përkatës përpara, që pas pikës 3 të nenit 127 të Kodit Rrugor, të shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje: “Pezullimi i parashikuar në dispozitat e këtij neni, në rastet kur kundërvajtësi jep pëlqimin, konvertohet me pagesën e një shume që është sa dyfishi i masës administrative maksimale të parashikuar për normën e shkelur”.

Neni 2, “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Ky është propozimi, të cilin e kemi votuar në parim në këtë komision. Natyrisht, kemi diskutuar edhe me përfaqësuesit e Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor dhe arritëm në këtë qëndrim të përbashkët, që t’u japim një mundësi alternative rasteve të pezullimit të lëshuara nga autoriteti juaj, që në rast se shtetasi që ka bërë shkeljen nuk është i gatshëm t’i nënshtrohet të gjithë procedurës që parashikon Kodi Rrugor në këtë pjesë, atëherë të mund ta konvertojë këtë gjë me pagesën e gjobës që shkon në dyfishin e maksimumit për shkeljen që ai ka kryer. Kjo është alternativa që propozohet për këtë pjesë.

Arsyet besoj se nuk kanë lidhje me qëndrime të caktuara politike, por priren të jenë të iniciuara nga qytetarë të ndryshëm kosovarë, por edhe të tjerë, shqiptarë apo të huaj, emigrantë që vijnë veçanërisht në periudhën e verës në Shqipëri, të ciët hasin këto probleme dhe, natyrisht, për ta është humbje kohe, pasi edhe procedura priret të jetë burokratike dhe e gjatë për shkak se bëhet fjalë për komunikime me një vend të huaj. Kështu që ne gjykuam se do të ishte në interesin e tyre, por njëkohësisht patëm parasysh që të mos cenohej edhe siguria rrugore dhe kjo pjesë që të mund të jetë një alternativë.

Sidoqoftë, prezenca e opozitës në komision ka qenë dhe është e dëshiruar që në momentin e parë, pasi realisht do të donim të dinim edhe qëndrimin tuaj në lidhje me këtë propozim, sepse ky është një ato amendime që nuk do të mund të kalonte nëse nuk do të kishim edhe konsensusin e opozitës. Kjo ishte ndërhyrja ime.

Fjala është për zotin Noka.

Flamur Noka – Tashmë është e qartë se me ligjet që kemi kaluar dhe ligjet që po sjellin gjatë kësaj periudhe në parlament, ky parlament ka humbur sensin e tij dhe është shndërruar as më shumë e as më pak vetëm në një noter të qeverisë, por në shumicën e rasteve ky parlament ka rezultuar që është noter i babëzisë së kësaj qeverie dhe Kryeministrit makut, që ka sot Shqipëria.

Rasti i Teatrit Kombëtar është rasti më flagrant. Votimi i atij ligji ishte një turp për parlamentin, ishte turp për të gjithë kolegët e maxhorancës. Është e paprecedentë, nuk bën vaki në

historinë e parlamentarizmit në Shqipëri apo në Europën demokratike apo në Perëndim, që qeveria, pasi ka vjedhur 5 vjet rresht me të gjitha mënyrat dhe format, t'i turret pronës publike si hiena, madje të hartojnë edhe ligje për ta rrëmbyer atë. Pse? Sepse duhet të shkatërrohet historia e kryeqytetit të këtij vendi, sepse duhet të vidhet çdo centimetër pronë e pazënë që ka mbetur që nga dita që mister babëzia, që sot është Kryeministër, erdhi në krye të bashkisë dhe në vazhdim me zogun e Tiranës. Pra, kjo qeveri nuk po njeh limite dhe ky parlament është bërë i turpshëm duke mbështetur vjedhjen haptazi dhe duke miratuar edhe ligje për të.

Sigurisht, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zogu i Tiranës është ky që drejton bashkinë, më besoni mua! Se ia thotë Edi Rama, pavarësisht se juve nuk jua nxë goja ta thoni!

Megjithatë, çështje tjetër themelore është raporti i antidrogës italiane. Antidroga e ka zhveshur cullak Kryeministrin dhe qeverinë tuaj. Shqiptarët kanë dëgjuar gënjeshtër dhe mashtrime të pafundme. Ata dëgjuan që Shqipëria nuk ka kanabis, që ajo është e pastër dhe që opozita është antishqiptare, sepse po sajon dhe intrigon në lidhje me kanabisin. Koha vërtetoi që kishim një Kryeministër me një kabinet mashtruesish dhe gënjeshtarësh, sepse Shqipëria ishte shndërruar në Kolumbinë e Europës. Ata u përpoqën që t'u hidhnin hi syve shqiptarëve dhe Europës, së bashku me disa ambasadorë të korruptuar, të cilët i përdorën deri ditën që ikën. Shqipëria u bë aerodromi i avionëve të drogës dhe e gjithë qeveria bëri sikur nuk e pa, sepse vetë i organizonte. Deti Adriatik u kthye në autostradën e drogës dhe në linjën e qarkullimit ajror që kishte Shqipëria me Europën. Madje, as në vitin 1939 nuk kaluan aq shumë avionë pushtues drejt Shqipërisë sa kanë kaluar avionë kaçatorrë të transportit të drogës në periudhën e “Rilindjes”. Qeveria dhe shërbimi i antidrogës italiane kanë nxjerrë një raport të frikshëm, ku përsëri e nxjerrin cullak Kryeministrin dhe qeverinë tuaj. A e mbani mend para disa kohësh ku, papritur dhe papandehur, Kryeministri juaj dilte dhe thoshte se në Shqipëri nuk ka drogë? Ndërsa një ditë të bukur iu mbush mendja dhe tha: “E fituam betejën me drogën”. Askund nuk e pamë ndonjë betejë apo ndonjë vullnet politik në luftën kundër drogës. Madje, në sytë tuaj, në sytë tanë dhe të gjithë shqiptarëve në parlament ky Kryeministër mashtrues, tha: “99,8% e drogës është zhdukur”, pra kishte mbetur 0,02% dhe këtu po flas për vitin 2017.

Në raportin e shërbimit të antidrogës italiane thuhet se në vitin 2016 u sekuestruan 41 tonë drogë. Pra, janë 41 tonë drogë, që i bie maksimumi vetëm 10% e saj sekuestrohej nga forcat

ligjzbatuese. Në vitin 2017, kur Kryeministri shpalli triumfin e luftës kundër drogës, rezultoi, sipas shërbimit të antidrogës italiane, që u sekuestruan 90 tonë drogë. Pra, u sekuestruan më shumë se dyfishi i vitit 2016. Ky është mashtrimi që Kryeministri, që quhet narko Edi Rama, u ka bërë shqiptarëve dhe të gjithë ndërkombëtarëve.

Në raportin e shërbimit të antidrogës italiane vlerësohet se importet në vitin 2017 janë rritur ndjeshëm dhe trendi i konfiskimeve lidhet me trendin e kultivimit. Kjo do të thotë se në vitin 2017 lufta e fituar kundër drogës ishte e gjitha një mashtrim, si të gjitha mashtrimet e tjera që ka nxjerrë nga goja Kryeministri në këta 5 vjet. Pra, kultivimi po njeh rritje. Edhe sivjet narkokryeministri edhe narkoministri vazhdojnë të thonë se në Shqipëri nuk ka kanabis, hqipëria është e mbushur me kanabis. Malet e Krujës dhe malet e Tiranës kanë filluar sërish të gjelbërohen nga droga qeveritare. Shikoni malet në Malësinë e Madhe, kodrat në Fier, malet në Vlorë, në Përmet, që po gjelbërohen me kanabis si kurrë ndonjëherë! Këtë gjë nuk e ka cilësuar vetëm antidroga italiane, por një kolonel i antimafies italiane me zë dhe me figurë ka thënë: “Sipas analizave që u janë bërë drogave të sekuestruara kohët e fundit në Itali ka rezultuar se të gjitha janë prodhim i muajve të fundit”. Pra, Shqipëria vazhdon të jetë një Kolumbi dhe kjo ka sjellë pasoja të frikshme te populli shqiptar. Vrasjet mafioze janë shtuar frikshëm dhe me këtë trend Shqipëria rrezikon të kthehet në Meksikën e Europës, ku bandat e drogës lajnë hesapet me njëra-tjetrën për pazaret e prishura të drogës. Qeveria mbyll sytë dhe nuk e shikon që në Shkodër situata është bërë alarmante, që në Vlorë, po ashtu, situata është bërë alarmante dhe ka dalë jashtë kontrollit, edhe në Elbasan është e njëjta situatë. Shqipëria sot nuk po qeveriset nga ata që kanë marrë besimin e qytetarëve të vendit, por po qeveriset nga narkoqeveria dhe krimi i organizuar. Askush nuk mund ta besonte se në Shqipëri, në vitin 2013, do të vinte në pushtet një qeveri jolegjitime dhe një pushtet i krimit të organizuar. Ky është realiteti sot, kjo është e zeza mbi të bardhë. Këtë nuk e themi vetëm ne, si opozitë, por e thonë partnerët tanë çdo ditë e më shumë, si edhe strukturat e specializuara të fqinjit tonë, Italisë.

Në raportin e antidrogës italiane thuhet: “Rastet e trafikimit të raportuara janë më të lartat në histori”. Pra, në kohën kur narkokryeministri e shpalli të fituar betejën kundër drogës, fqinji ynë na thotë se rastet e raportuara të trafikimit janë më të lartat në histori. Kë duhet të besojmë ne tani?! Të besojmë një Kryeministër të babëzitur, që e kanabizoi Shqipërinë dhe e bëri trampolinën e trafikut të drogave të forta, që e bëri çerdhen e krimit të organizuar europian, apo do të besojmë partnerët tanë seriozë dhe fqinjin tonë, Italinë? Sigurisht që do të besojmë fqinjin tonë, Italinë dhe partnerët tanë, sepse ky Kryeministër tashmë nuk është më i besueshëm. Pse? Është i pabesueshëm

sepse ka gënjyer për çdo gjë. Shqiptarët janë dëshmitarë të të gjitha premtimeve që ka dhënë ai në vitin 2013. A mund të më thoni ju apo edhe vetë Kryeministri se çfarë premtimi ka mbajtur? Asnjë, sepse të gjitha janë gënjeshtër!

Ermonela Felaj – Ai i ka mbajtur premtimet.

Ne mund të japim të gjitha përgjigjet që ju doni, por ti e kupton shumë mirë se kjo që po bën është tërësisht jashtë procedurës dhe jashtë çdo gjëje. Ne po ju dëgjojmë, por kolegët po më thonë se jemi mbledhur për Kodin Rrugor. Ne e mirëpritëm prezencën tuaj me besimin që ju do të vinit për të folur lidhur për çështjen. Unë, që në krye të herës, jua thashë se ky nuk është një propozim që i intereson një partie politike.

Flamur Noka – Unë e kuptoj shqetësimin tuaj!

Ermonela Felaj – Unë nuk kam problem lidhur me këtë pjesë.

Flamur Noka – Zonja kryetare, unë e kuptoj shqetësimin tuaj dhe të kolegëve. Jam shumë i prirur që t'ju mirëkuptoj, por, ju lutem, duhet të jeni të qartë për një gjë: ne do të vazhdojmë t'u biem kambanave të alarmit. Pavarësisht se Kryeministri ju ka vënë juve një perde rozë në sy, pavarësisht se ju ka hedhur hi syve, të gjithë shqiptarët janë zgjuar. Ndaj, ju vazhdoni ta mbani atë perde rozë dhe ta shikoni realitetin rozë, por realiteti sot në Shqipëri është i frikshëm. Ne po ju themi se koha nuk është më as juaja dhe as e kësaj qeverie. Ashtu siç i doli e vërteta e Saimir Tahirit, kur Kryeministri e mbrojti këtu si ministrin më të suksesshëm, si idhullin e qeverisë, por që rezultoi se ishte kreu i narkotrafikantëve dhe në shërbim të bandave të drogës, ashtu na rezultoi edhe sot, se përsëri keni vënë një ministër trafikant, i cili ka një vëllë të dënuar për trafik droge. Ju vazhdoni sikur nuk ka ndodhur asgjë, por këto janë çështje që nuk mund të kapërdihen kaq kollaj.

Unë e kuptoj shqetësimin tuaj, por shqetësimi ynë, shqetësimi i opinionit publik, sigurisht edhe shqetësimi i faktorëve ndërkombëtarë është se nuk mund të vazhdohet me këtë qeveri, e cila është totalisht e inkriminuar dhe e korruptuar; nuk mund të vazhdohet më me këtë qeveri, e cila nuk përfaqëson vullnetin, por është shndërruar në një regjim autoritar; nuk mund të vazhdojë Shqipëria të këtë një kryeministër, i cili merr si shembull Erdoganin apo Putinin, pasi atje nuk ka qeverisje demokratike, por ka regjime.

Shqiptarët nuk janë orientalë, nuk janë as lindorë, por janë një popull gjenetikisht perëndimor dhe europian dhe nuk mund të pranojnë as narkoqeverinë, as diktaturën dhe as një kryeministër arrogant, mashtrues dhe hajdut. Vitin që shkoi ne bëmë disa deklarata, ku ju thamë se ky vit ishte viti i fundit i qeverisë suaj, por unë po ju them se vjeshta e këtij viti do të jetë vjeshta

betejës për të rrëzuar qeverinë tuaj. Unë po ju them se Edi Ramën nuk ka për ta zënë Viti i Ri si Kryeministër, si dhe këtë narkoqeveri. Opozita është e gatshme dhe ka filluar aksionin e saj për t'i dhënë fund dhe për ta rrëzuar këtë qeveri. Vjeshta do të jetë një dimër i madh për të gjithë hajdutët, për krimin e organizuar të këtij vendi, si dhe për të gjithë narkoqeverinë. Ky do të jetë një dimër i acartë për Kryeministrin. Prioriteti ynë do të jetë në parlament dhe kudo, me çdo qytetar në çdo shesh derisa ta gjunjëzojmë këtë narkoqeveri, e cila sot nuk po qeveris, por thjesht po sundon. Vjeshta do të jetë dimri i acartë juaji.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Kur ishim në moshën shkollore na thoshin se përsëritja është mëma e dijes, por kjo nuk vlen për këtë rast, sepse nuk jep ndonjë dije, që ia vlen ta marrin njerëzit! Sidoqoftë, meqenëse ju jeni edhe nënkryetari i këtij komisioni, unë e kam të qartë se nuk keni ardhur këtu për të folur për Kodin Rrugor. Natyrisht, ju keni qëndrimin tuaj, dhe kjo nuk është gjë e re për ne. Unë shpresoj që ju të bëni pushime, të merrni veten, në mënyrë që më pas të bëni detyrën e opozitës, të cilën nuk po e shikojmë ta bëni.

Kalojmë me votimin e projektit.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fjalën e ka zoti Qefalia për procedurë. Më pas fjalën e ka zoti Salianji për nenin 1 të projektligjit.

Xhemal Qefalia – Zonja kryetare, tashmë qytetarët shqiptarë e kanë shumë të qartë dhe e dinë recitalin e këtyre individëve, të cilët vazhdojnë ta lançojnë në çdo komision. Kam vërejtje për mënyrën sesi po funksionon drejtimi i komisionit. Në vend që ne të jemi të gjithë solidarë dhe të falënderojmë zotin Ndreu, i cili po ndreq një gabim, që e kemi bërë ne dhe kemi votuar bashkërisht, pozitë dhe opozitë, ne jemi të detyruar të dëgjojmë recitalet, që kanë po të njëjtën kasetë. Prandaj, zonja kryetare, nëse do të diskutojmë për këtë ndryshim të nenit që ka ardhur, atëherë le ta bëjmë këtë gjë. Koha e diskutimit në parim të këtij neni ishte në seancën e shkuar, kurse sot jemi për të miratuar këtë nen, pra për ta modifikuar, pas sugjerimeve që u bënë. Nëse do të bëhet kështu, atëherë jam dakord.

Lidhur me pikën 3, që e kemi të ndryshme vazhdimisht në komision, le t'i japim hapësirë secilit prej deputetëve të flasë se si e mendojnë. Prandaj, unë jam i mendimit që të kalojmë menjëherë te pjesa se çfarë duhet ndryshuar te ky nen.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ermonela Felaj – Tani diskutimet për këtë nen ne i kemi bërë, sepse vetëm ky nen është. Sipas diskutimeve që u bënë një ditë të tërë në këtë komision, kjo është përmbajtja që propozohet për këtë nen, kështu mos bëni sikur çfarë ka këtu për të diskutuar. Pra, ose biem dakord, ose nuk biem dakord me këtë nen.

Zoti Salianji, ju keni kërkuar fjalën që të flisni për nenin, por po ju paralajmëroj: në rast se nuk do të flisni pikërisht për nenin, do të jem e detyruar të kaloj direkt në votim.

Ervin Salianji - Mos u bëni si mësuese kujdestare, se nuk ka sens kjo punë tani!

Ermonela Felaj – Nuk ka vend mësuesja këtu.

Ervin Salianji – Atëherë, çfarë është kjo punë?

Ermonela Felaj – Përderisa komisioni mbledhet në bazë të një Rregulloreje dhe njerëzit përpiqen të jenë të sjellshëm me njëri –tjetrin, edhe ju duhet t’i respektoni.

(Diskutime pa mikrofon.)

Respekti është reciprok. Në qoftë se ne ju dëgjojmë dhe ju respektojmë si kolegë, kjo nuk do të thotë që ju ta bëni baltë këtë histori dhe ne duhet vetëm t’ju dëgjojmë, sepse edhe kështu nuk shkon.

Ervin Salianji – Unë e kuptoj që ju keni interes për të bërë zhurmë.

Ermonela Felaj – Neve na intereson të flisni për Kodin, atëherë flisni për Kodin, sepse nuk është serioze kjo punë kështu.

Edhe një herë, për njerëzit që na dëgjojnë: kur e kemi shpallur këtë gjë, natyrisht, ka marrë shumë mbështetje, sepse ata që e vuajnë janë qytetarët. Kjo është njësoj, unë jua kam thënë edhe në atë kohë shumë singërisht...

Ervin Salianji – Ju lutem, mos më bëni moral, por më jepni fjalën që të flas për nenin!

Ermonela Felaj – Fjalën do ta merrni pasi të mbaroj unë së foluri, dakord!

Ervin Salianji – Mos më bëni moral, por më jepni fjalën që të flas për nenin!

Ermonela Felaj – Unë po të bëj moral për të vetmen arsye, sepse ne jemi këtu për të bërë diçka që i shërben publikut.

Ervin Salianji – Moralin bëjeni diku tjetër, sepse unë nuk jam as kishë dhe as xhami! Ju nuk jeni mësuese kujdestare!

Ermonela Felaj – Nëse doni të bëni fjalë me njëri-tjetrin, nëse doni të bëni polemika, kjo nuk i intereson askujt.

Ervin Salianji – Përfundojeni fjalën tuaj tani, që të vazhdoj unë.

Ermonela Felaj – Zoti Salianji, mos ndërhyri kur unë flas!

Merrini fjalën dhe flisni për nenin.

Ervin Salianji - Në këtë rast nuk kam asnjë kompleks që të përgëzoj kolegun për nismën që ka propozuar për t'u dhënë një zgjidhje qytetarëve. Nuk mendoj se kalimi i veçantë i këtij neni do t'i zgjidhë të gjitha problematikat që kanë qytetarët me Policinë Rrugore apo pasojat që të çojnë te Kodi Rrugor. Unë nuk besoj se ju e keni bërë për show për të sjellë një nen që u jep zgjidhje qytetarëve për këtë periudhë, më e pakta do të kishit dëgjuar dhe do të dëgjonit më me qetësi opozitën, sepse është një ligj që kalon edhe me votat tona. Nuk besoj se e keni sjellë për show, sepse qytetarët kanë problematika shumë më të mëdha, duke nisur që nga radhët e gjata që mbajnë në komisionet e patentave. Ju mund të propozonit, por edhe së bashku mund të arrinim në një dakordësi, për ta detyruar Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme të shtojë sportelet, t'i dixhitalizojë apo çfarëdolloj forme tjetër. Unë nuk besoj se ashpërsimi i masave represive do të zgjidhë situatat e kundërvajtjeve, sepse deri më sot nuk kanë rezultuar efektive. Disa muaj më parë qeveria ka sjellë propozim për rritjen e masës së gjobës për vendosjen e rripit të sigurimit, rritjen e masës së gjobës për shpejtësinë, burgim për rastet e konsumimit të alkoolit e të tjerë, ndaj unë nuk besoj se ky nen është problemi themelor i shqiptarëve. Unë nuk besoj se ky nen i propozuar veçmas dhe për show u jep zgjidhje problemeve të përditshme që kanë qytetarët. Problemet si krimi dhe korrupsioni janë shumë më të mëdha, siç i tha pak më parë edhe zoti Noka. Kështu që propozoj ta tërhiqni këtë nen dhe të kërkonit dakordësi për pikat e tjera të Kodit Rrugor për t'u dhënë zgjidhje reale problemeve të qytetarëve dhe të gjitha shqetësimeve që ata kanë. Pra, mos bëni këtu propagandë vetëm për një nen, e cila, në fakt, u jep zgjidhje vetëm një pjese të qytetarëve që jetojnë në emigracion dhe që vijnë këtu vetëm për pushime. Pra, ky nen nuk u jep zgjidhje të gjithë qytetarëve, që jetojnë në Republikën e Shqipërisë, të cilët dhe kanë probleme që vijnë nga Kodi Rrugor.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Ndreu si relator.

Më pas e ka fjalën zoti Murrizi.

Pjerin Ndreu - Unë dua t'ju falënderoj që jeni dakord me ndryshimin.

Së pari, kjo nuk ka të bëjë me një show, por me një realitet dhe ka të bëjë me një histori, e cila është në ngërç. Këtë gjë e kemi hasur të gjithë, nuk e kam hasur vetëm unë. Ka një burokraci të tmerrshme në rastet e patentave të huaja, ku penalizohen kryesisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të zgjidhim njëherë të huajat, se të brendshmet kanë zgjidhje, pasi shkon në komision dhe për tri ditë e merr, por të huajat nuk i merre për tre muaj. Qytetarët që jetojnë këtu e kanë më të thjeshtë, sepse janë këtu, nuk u ikën vendi i punës. Pra, ka një problematikë, që është e pazgjidhshme. Ju gjykojeni si të doni, por kjo është një çështje, të cilën gojarisht e kam diskutuar edhe me ju, por problemi është që të miratohet në korrik, sepse në gusht fillon ardhja e emigrantëve dhe fluksi i madh i pushuesve nga Kosova. Te ky nen duhet të ndërhyjmë shumë shpejt, sepse kushtëzohet nga sezoni i pushimeve që vjen. Kjo nuk ka lidhje që ne të bëjmë *show*, por të zgjidhim një ngërç.

Çfarë ndodh? Një emigrant bën 10 shkelje dhe, sipas Kodit Rrugor, atij i hiqet patentja, e cila nga policia kalon te prefekti, që e dënon nga një deri në tri muaj, nga prefekti kalon në polici, nga policia në Ministrinë e Jashtme dhe nga Ministria e Jashtme zyrtarisht me postë në konsullatën e vendit ku adresohet. Ka pasur raste kur emigrantët kanë humbur vendin e punës, sepse vendi i punës varet nga patentja. Ka pasur raste kur janë nisur për pushime familjarisht, me gruan dhe fëmijët, dhe kanë ngelur në rrugë me ditë të tëra, sepse ne nuk kemi asnjë mekanizëm për t'ia rikthyer patentën. Në Kosovë e merr patentën, duke paguar një gjobë, e cila shkon deri në 200 euro, ndërsa shtetasve kosovarë dhe atyre maqedonas ne nuk ua japim dot mundësinë ta marrin patentën. Kjo është një masë alternative, e cila lihet në dëshirën e personit nëse do ta paguajë apo të respektojë afatin e vendosur në gjobë. Kjo nuk ka të bëjë me efektin financiar të gjobave në buxhet, sepse ka teori që mbledh lekë, 600 shkelës që ishin në një vit, është një shifër qesharake dhe e papërfillshme. Pastaj e kemi lënë në zgjedhjen e vet personit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka të bëjë me show, por ka të bëjë me ndihmën që ne u japim emigrantëve, shtetasve kosovarë, maqedonas dhe atyre të huaj që vijnë tani në gusht. Kjo është një zgjidhje që duhet t'ua japim të gjithë ne. Nëse do ta lemë që t'u merret patentja, shtetasit që vijnë me pushime këtu do të vijnë vërdallë dhe nuk do të mbarojnë dot punë, ata do të humbasin vendin e punës atje, sepse koha minimale e heqjes së patentës është 3 muaj. Kjo është një procedurë që zgjat dhe është problem për ata.

Së bashku me ekspertët kemi identifikuar edhe një grup ndryshimesh të tjera, për të cilat ne jemi të hapur që t'i diskutojmë, por kryetarja e komisionit e bllokoi hyrjen e ndryshimeve të tjera, sepse ne si komision mund të rakordojmë për 1,2,3-10 gjëra, por nuk ka ndonjë emergjencë. Unë jam dakord që të ndërhyjmë edhe te komisionet, sepse jemi para sezonit dhe është emergjente ndërhyrja në këtë nen. Kanë ardhur njerëzit duke qarë dhe ne nuk kemi pasur mundësi t'i ndihmojmë, kanë ardhur miq nga Kosova, akademikë dhe njerëz shumë të nderuar që u është marrë patenta, duke ecur me shpejtësi tej normave të lejuara, kjo është normale, sepse kanë bërë shkelje, por nga ana tjetër ne duhet t'u japim atyre edhe një mundësi tjetër, që ata të paguajnë dyfishin e gjobës për marrjen e patentës. Por jemi edhe para faktit se shumë emigrantë bëjnë spektakël dhe shkaktojnë kaos në trafik. Ne u kemi dhënë edhe një mundësi, e cila është në dëshirën e vetë personit, nëse do të presë 3 muaj, le të presë, por nëse nuk do, atëherë të paguajë dyfishin e gjobës dhe të marrë patentën. Kjo është një lehtësi që i jepet një kategorie të caktuar, e cila nuk jeton këtu. Kjo është parimore dhe nuk është *show*. Nëse nuk doni që ta bëni, mos e bëni, sepse as humbim dhe as fitojmë gjë. Unë mendoj se duhet të jemi të gjithë bashkë në këtë propozim. Ju mund ta përktheni dhe ta gjykoni si të doni.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Murrizi.

Myslim Murrizi – Faleminderit!

Edhe unë jam dakord me ndryshimin e propozuar nga zoti Ndreu, por shikoj një diskriminim për pjesën shqiptare. Nëse është kaq urgjente, zoti Ndreu, por edhe çdo koleg i nderuar brenda dhe jashtë këtij komisioni, por edhe vetë qeveria nëse do të kishin hallin e emigrantëve, nuk po them se është *show*, nuk kishim përse ta linim në seancën e fundit, propozimi mund të kishte ardhur në janar, në shkurt, mars apo në prill, sepse ne e dimë këtë shqetësim. Ky shqetësim nuk është miratuar nga unë personalisht, por është miratuar me konsensus para 4-5 vjetësh, një pjesë e juaja keni qenë në Kuvend. Por ka pasur një strategji nga hartuesi apo propozuesi i asaj kohe, ish-ministri i Brendshëm Tahiri për të bërë *show*. Ai gjobiste kolegët deputetë, edhe të maxhorancës së sotme, ndiqte makinën e Ministrisë së Mbrojtjes së Mimi Kodhelit për të bërë vidioklip. Pra, ky i drogës po luftonte shkeljet e qarkullimit rrugor. Ka qenë një turp kur dy vajza police ndiqnin makinën e Mimi Kodhelit deri te ministria ku edhe e gjobitën, ju ka gjobitur edhe ju në dyert e Partisë Socialiste, për të treguar se ishte korrekt me ligjin, por, në fakt, e bënte për të tërhequr vëmendjen nga ajo që realisht ishte për të pasur vëmendje.

Unë jam plotësisht dakord që emigrantët humbin vendin e punës nga ajo patentë, por jo pak e humbin vendin e punës edhe ata fermerë myzeqarë, që duhet të shkojnë katër ditë me radhë në Fier për të dalë në komision. Po ai nga Grabova e Përmetit, që duhet të shkojë në Gjirokastrë, po ai nga Surroi i Kukësit që duhet të shkojë në qendër të qarkut, po ai nga Hasi dhe nga Tropoja? Ne e shikojmë që realisht ka nevojë për ndryshim, sepse është një kod demagogjik dhe sinqerisht më vjen rëndë kur kujtoj atë specialistin që thoshte: ta shtrëngojmë këtë dhe këtë. Nga gjithë ky shtrembërim që keni i bërë në gjithë këto vite, a është ulur numri i aksidenteve? Pra asgjë nuk është bërë, ju vetëm jepni evidenca të shtune dhe të diele për 4600 gjoba që keni vendosur këtu, 7800 gjoba që keni vendosur diku tjetër, sikur të ishte plan kooperative.

Unë jam plotësisht dakord ta ndryshojmë jo vetëm për këtë kategori, por ta ndryshojmë edhe për shqiptarët, sepse u thuhet që të shkojnë në komision, por njerëzit sorollaten, sepse nuk caktohet dita e komisionit, duhet të presësh radhën dhe të thonë: hajde të enjten tjetër. Tirana ka 1 milion banorë.

Ermonela Felaj – Është normale, sepse ke bërë shkelje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fjalën e ka zoti Ndreu.

Pjerin Nderu – Është e vetmja procedurë që nuk ka zgjidhje, sepse është ngërç. Kjo nuk ngjan me procedurën e shtetasve që banojnë në Shqipëri, edhe këtu ka probleme, por nuk mund të barazohen si problematika. Kjo problematikë është e pazgjidhshme. Në rastin më të mirë duhen 3 muaj për të marrë patentën. Nuk ka fare zgjidhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë problematikë e kam identifikuar me fluksin e shtetasve kosovarë, që i kapin në Milot, diku nga muaji mars. Këtë problematikë e kam diskutuar edhe me ty, por edhe me kolegët e tjerë të opozitës dhe në parim kemi qenë të gjithë dakord që duhet bërë ky ndryshim.

A duhen bërë ndryshime në Kodin Rrugor? Po, duhen dhe unë jam dakord, por kjo është një ndërhyrje që rregullon diçka që nuk ka zgjidhje. Është një ngërç, është një skandal që i penalizon njerëzit dhe i lë pa punë, nuk i lë të udhëtojnë me familjen, i lë në mes të rrugës, pra është një situatë emergjente. Penalizon shtetasit kosovarë dhe maqedonas që vijnë për pushime.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky ndryshim është vetëm për patentat e huaja, për emigrantët që punojnë si shoferë. Më thanë një rast, që kishte ardhur njëri nga Amerika dhe nuk e merrte dot patentën për 3 muaj dhe ai

vetë ikte mbas një muaji. Çfarë do të bësh? Kjo është një zgjidhje që ia lë në dorën e tij dhe kjo gjë nuk lë shkak për korrupsion. Ka ndodhur që kanë paguar nga 500 deri në 1000 euro, për të marrë patentën në rrugë të tjera, ndërsa ky paguan dyfishin e gjobës që shkon maksimumi në 100 mijë lekë.

Nëse ka ndonjë propozim se si mund ta modifikojmë, ejani ta diskutojmë, por në parim ne duhet t'i japim zgjidhje këtij problemi, që është më i rëndi në Kodin Rrugor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është i pazgjidhshëm, çdo prefekt e ka me ligj që të marrë masë 1deri në 3 muaj.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Salianji.

Ervin Salianji – Nuk ka diskutim që i gjithë përshkrimi dhe situata e qytetarëve me administratën është edhe më e zezë. Ju nuk mund të silleni si opozitë, më shumë sesa kaq është situata e çdo qytetari që përballet në dyert e administratës. Nëse ka një zgjidhje dhe nuk ka propagandë dhe *show*...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka vetëm një zgjidhje, procedurat që përcakton ligji në të gjitha hallkat e administratës, që nga prefekti deri te komisionet, të kalojnë brenda një ose dy ditësh, meqenëse janë 600 raste, të kalojnë në mënyrë të përshpejtuar. Këtu nuk është problemi për 600 raste që ndodhin në vit, ne po themi që t'i hyjmë me themel, sepse mijëra qytetarë shqiptarë po lënë punën, dhe po humbin kohën e çmuar duke shkuar në komisione, sepse ju e dini se si e lënë makinën e lënë në një cep të Tiranës dhe pagesën e bëjnë në Kinostudio. Ju e dini që po të shkosh në komisione, duhet të presësh ditë me radhë që në 5 të mëngjesit dhe nuk të japin zgjidhje. Ky nuk është vetëm një rast.

Pjerin Ndreu – Ju lutem, mos bëni politikë.

Ervin Salianji – Prandaj ky propozim për një nen të posaçëm nuk e zgjidh këtë situatë.

Ermonela Felaj – Dakord, zoti Salianji, e kuptuam këtë. A mund të bësh një propozim konkret, sepse ti thua, kur nuk zgjidhim atë që dua unë, të mos zgjidhim asgjë.

Ervin Salianji – Propozimi është që administrata publike, prefekti dhe Policia e Shtetit t'i mbyllin brenda 3 ditësh, në mënyrë që këto raste të kalojnë në mënyrë të shpejtë. Nuk ka afate, janë vetëm vonesa që sjell administrata publike.

Ermonela Felaj – Dakord, por bëhet fjalë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor dhe nuk bëhet fjalë për gabime gramatikore, pra bëhet fjalë për shkelje që nesër marrin jetë njerëzish. Nuk mundesh që kundërvajtësit e shkeljeve rrugore t'i lëmë pa sanksion.

Ervin Salianji – Ju nuk po hiqni afatet, ju po propozoni heqjen e afateve...

Ermonela Felaj – A ka mundësi të mbani qetësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund të flasim të gjithë me nga 30 sekonda, sepse nuk kemi procedurë, kemi diskutuar për këtë nen, ose jemi dakord ose nuk jemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetëm nëse ka pyetje për këtë nen, Flamur, sepse nuk ka kuptim. Ju nuk po e ndihmoni debatin, por po hidheni në anën e kundërt dhe harroni që ka me dhjetëra dhe qindra njerëz që kanë humbur njerëzit e tyre në aksidente. Tani thoni a ka mundësi t'ua bëjmë shpejt edhe këtyre? Jo, nuk është kështu. Ato, do të mbajnë përgjegjësi deri në fund, do të paguajnë gjobë ose do të shkojnë në burg. Ne po themi për këtë rast, a mundemi të ndërhyjmë në këtë procedurë, që është e gjatë vetiu, sepse bëhet fjalë për leje drejtimi të huaja dhe nuk bëhet fjalë për ato vendase, pra a mundemi të fusim një alternativë që ai të mos i nënshtrohet gjithë rrugës së gjatë, që nga prefekti e me radhë, por të paguajë dyfishin e gjobës dhe të marrë lejen e drejtimit?

Fjalën e ka zoti Ndreu dhe kalojmë më pas në votim.

Pjerin Ndreu – Ne nuk duam ta politizojmë këtë debat për sa kohë kemi të bëjmë me një kategori të caktuar personash, të cilëve marrja e patentës është katastrofike për ata. Po të jetë puna për ta politizuar, zotërinj, ligji është bërë në vitin 2007 dhe është ndryshuar në vitin 2011 dhe gjithë kjo zallamahi e ligjit, meqenëse ti përmende disa gjëra, vijnë për shkak të maxhorancës së asaj kohe, por ne nuk duam t'i hyjmë atij diskutimi, sepse nuk është normale për këtë ndryshim të themi se kush e bëri ligjin dhe si e bëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të flas? Për mendimin tim, ne kemi ndërhyrë në një pikë emergjence, sepse jemi përballur me situata skandaloze. Të mos bëjmë politikë dhe të mos rreshtojmë 1000 arsye përse ligji është bërë kështu.

Ka edhe një problem, sepse shoqëria është dinamike dhe ligji ka nevojë për ndryshime të herëpashershme dhe kjo është krejt normale. Nëse identifikohen raste ku ligji nuk vjen në përshtatje me një aspekt të caktuar shoqëror, atëherë ligji të ndryshohet, sepse nuk ka asnjë të keqe. Ne po ndërhyjmë në një pikë. A doni të ndërhyjmë në 10 apo në 20 pika? Ejani dhe t'i bëjmë të gjitha bashkë. Ky ndryshim është emergjent, sepse vijnë emigrantët dhe ne nuk u japim dot një zgjidhje. Ne jo vetëm që u marrim patentën, por u heqim edhe mundësinë për të fituar bukën e

gojës, sepse i heqim nga puna. Ta miratojmë këtë dhe pastaj ejani të bëjmë diskutime politike sa të doni.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka zoti Noka.

Flamur Noka – Tani që të mos mbyteni te pika e ligjit. Ky ligj është hartuar në përputhje me *acquis communautaire*, me propozimin e aleatëve tanë europianë. Nëse bëni një diskriminim pozitiv për bashkatdhetarët tanë që janë jashtë, apo edhe për ata që jetojnë në Kosovë dhe Maqedoni, sigurisht që duhet të bëni të njëjtin diskriminim edhe për shqiptarët që jetojnë në Shqipëri. Problemi themelor në këtë vend, e theksoj, nuk është as mungesa e legjislacionit dhe as legjislacioni i gabuar, prandaj ju vjen keq kur e themi, problemi themelor është mungesa e vullnetit për të respektuar ligjin dhe keqpërdorimi i tij. Rastin konkret është, vetingu i famshëm, që po zbatoni në mënyrën më të poshtër, duke shkatërruar drejtësinë. Gjyqtari Dizdari shkarkohet, sepse ka një kushëri që paska probleme; gjyqtari Tom Ndreca shkarkohet, sepse kunati i tij është përdorues hashashi dhe është kapur me 0,4 gram hashash dhe qeveria juaj e quan atë anëtar të krimit të organizuar, ndërsa vëllai i ministrit të Brendshëm i dënuar për trafik droge, nuk është anëtar i krimit të organizuar dhe ministri i Brendshëm duhet të rrijë në detyrë. Ky është problemi, pra nuk zbatohet ligji dhe ka dy standarde.

Ermonela Felaj – Të mos bëhemi mburoja politike e gjyqtarëve dhe prokurorëve, që nuk konfirmohen dot në detyrë.

Flamur Noka – Dikush dënohet përse kunati i tij ka pi një cigare, hashash ndërsa tjetri e ka vëllain të dënuar dhe vazhdon të qëndrojë ministër. Ky është problemi në Shqipëri, sepse në të gjitha fushat ka dy standarde, një për qeverinë dhe një për pjesën tjetër.

Ermonela Felaj – Flamur, e keni votuar reformën në drejtësi dhe keni rënë dakord që gjyqtarët dhe prokurorët, që kanë probleme me figurën, duhet të largohen një orë e më parë nga sistemi. të mos bëhemi mburojë e askujt.

Flamur Noka – A ka probleme ministri në figurën e tij? Ma pranoni. Nëse Tom Ndrecaj ka kunatin që ka pirë një cigare hashash dhe paska problem, po ministri a ka probleme figurën e tij që ka vëllain të dënuar për trafik droge dhe i ka dhënë imunitet dhe e ka mbrojtur?

Ermonela Felaj – Të mos bëhemi mburojë e askujt. Nëse ke probleme me ministrin dhe me të tjerë, Rregullorja të lejon ta thërrasësh ministrin këtu, por ti nuk e bën këtë gjë. Ti nuk thërret asnjë njeri që ta bësh këtë debat.

Flamur Noka – Në rast se Gani Dizdari paska një njeri, burrin e mbesës, apo nipin, apo ku ta di unë, me probleme, a mund të rrijë si ministër ai që ka vëllain në burg? Këtë ma shpjegoni. A janë standarde demokratike këto? A përdoren dy standarde, një për qeverinë dhe një për pjesën tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe për ligjin po ju them, Shqipëria nuk vuan për mungesë ligjesh, por vuan për arrogancë në zbatimin e tij, ndryshe zbatohet për qeveritarët dhe ndryshe për qytetarët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë nuk e mohoj që ai ligj ka procedurë burokratike, por është propozim i Bashkimit European.

Ermonela Felaj – Është e qartë që nuk arrijmë në një konkluzion të përbashkët për këtë nen, sidoqoftë, kthehemi te miratimi i nenit.

“Pezullimi i lejeve të drejtimit, të lëshuara nga një shtet i huaj, në rastet kur kundërvajtësi jep pëlqimin, konvertohet me pagesën e një shume që është sa dyfishi i masës administrative maksimale të parashikuar për normën e shkelur”.

Kush është dakord me përmbajtjen e këtij amendimi që citova?

Faleminderit! Kolegët e maxhorancës janë dakord. Kundër? Një votë kundër. Abstenime? Ishte e gjithë opozita.

Neni 2. Kush është dakord me hyrjen në fuqi?

Faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Kush është dakord në tërësi me propozimin e zotit Ndreu?

Faleminderit, kolegë të maxhorancës, për këtë votim!

Miratohet amendimi i propozuar nga zoti Ndreu.

Mbledhja mbyllet këtu.

MBYLLET MBLEDHJA